

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Ndërtimi i linjës së re 220 kV dopjo qark Fier – Hoxharë me përcjellës ACSR 490/65, si dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë, bashkë me dy dalje linje 220 kV”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

45232221-7 - Nënstacion transformator

31321100-3 - Linja ajrore të energjisë elektrike

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

1,362,518,540 (një miliard e treqind e gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 11,691,423.9 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e tre pikë nëntë) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 05.12.2022 (1 EUR = 116.54 ALL).

**Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:**

Ndërtimi i nënstacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë dhe linjes së re 220 kV dyfishe Hoxharë – Fier dhe Hoxharë-TEC Vlore (çarja e linjes ekzistuese Fier-Babice). Fuqia transformuese e këtij nënstacioni do të përgjigjet dinamikave të zhvillimit (ndërtimit) të parqeve foto-voltaike. Ky investim do të bejë të mundur absorbimin në rrjet e të gjithë kapacitetit gjenerues që pritet të ndërtohen në këtë rajon.

Implementimi i këtyre projekteve do të ketë vështësi pasi do të kërkojë daljen nga operimi të elementeve të skemës për periudha relativisht të gjata por e rëndësishme është që të jenë të bashkërenduar dhe të shtrira në kohë brenda një afati të arsyeshëm.

Nisur nga eksperiencia e mëparshme lidhur me implementimin e projekteve të ngjashme, ky projekt duhet të trajtohet si një i tere, pra ndërtimi i nënstacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë dhe

linjes se re 220 kV dyfishe Hoxhare–Fier dhe Hoxhare-TEC Vlore (çarja e linjes ekzistuese Fier-Babice) te ndertohet nga nje ofertues per te garantuar ecjen ne paralel te punimeve si ne ndertimin e linjes edhe te nenstacionit, pasi ne te kundert do te kemi vonesa ne kohe ne venien ne operim dhe berjen efektiv te investimit.

AK eshte nje institucion i rendesise se vecante ne sistemin elektro-energjitik shqiptar dhe gjithashtu ben edhe lidhjet e nevojshme me vendet fqinje dhe per kete arsye.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit te Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 1,500,000,000 (nje miliard e peseqind milion) Leke.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e sipërper mendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros duhet të jete në masën 1,500,000,000 (një miliard e pesëqind milion) Leke.

---

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

*2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 500,000,000 (pesëqind milion) leke. Nga këto punime të pakten 200,000,000 (dyqind milion) leke punë të jene punime në linjat e tensionit të lartë 220 kV e lart dhe 300,000,000 (treqind milion) leke punë të jene punime në Nënstacione elektrike 220 kV e lart. Këto kontrata duhet të jene realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 2,000,000,000 (dy miliard) leke. Nga këto punime të pakten 800,000,000 (teteqind milion) leke punë të jene punime në linjat e tensionit të lartë 220 kV e lart dhe 1,200,000,000 (njemiliard e dyqind milion) leke punë të jene punime në Nënstacione elektrike 220 kV e lart. Këto kontrata të jene realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

**Shenim:** Kontrata te ngjashme persa i perket punimeve elektrike per vete specifiken qe kane, do te kosiderohen punimet ne Linjat elektrike me nivel tensioni  $\geq 220$  kV, si dhe punimet ne Nenstacionet elektrike me nivel tensioni  $\geq 220$  kV.

**Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve te nenit 88, pika 3, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, kushti i përcaktuar më sipër në lidhje me kontratat e ngjashme plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, punimet e kerkuara dhe natyren specifike te kesaj kontrate, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete sipas parashikimeve ligjore. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Përsa i përket cilësimit të kontratave të ngjashme, sipas opinionit teknik te inxhinierëve te AK gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, sqarojmë se Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. administron rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike me tension 110-400 kV, që përbëhet nga nënstacionet 400/220 kV, nënstacione 110/TM kV dhe linjat 110/220/400 kV.

Për të garantuar funksionimin normal dhe të sigurtë të sistemit elektro-energjetik, OST sh.a. ka për detyrë zhvillimin, automatizimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen e komponentëve të Sistemit të Transmetimit.

Theksojmë se, OST sh.a. është institucioni i vetëm menaxhues i objekteve me këto nivele tensioni.

Garantimi i qëndrueshmërisë të Sistemit Energjetik si dhe siguria e furnizimit me energji elektrike në tensionet e larta bazohet në zbatimin e rreptë të rregulloreve të Sigurimit Teknik dhe të Shfrytëzimit Teknik të Nënstacioneve dhe Linjave të Sistemit Energjetik.

Për të bërë një krahasim të nivelit teknik/profesional të kërkuar në punimet në pajisjet e tensionit të lartë argumentojme si vijon për punimet me nivel tension 220 kV:

---

- Rrjetet 220 kV, administruar nga OST sh.a. janë të ndërtuar në ajër (AIS) pra, përdorin qëndrueshmëri të elektrike të ajrit si material izolues. Ato kërkojnë sipërfaqe të madhe dhe në shumë raste punime në hapësira që janë afër pajisjeve nën tension të lartë që paraqesin rrezikshmëri të lartë për operatorët. Puna e tyre mbikëqyret dhe kushtëzohet nga kërkesat e rregulloreve të sipërpërmendura. Në nënstacion/linja mund të punojnë vetëm operatorë të instruktuar dhe me kartelë të sigurimit teknik.
- Pajisjet primare vendosen në bazamente betoni të armuar dhe konstruksione mekanike të veçanta. Theksojmë që pajisjet primare janë të rënda dhe njëkohësisht tepër delikate. Ato kërkojnë makina ngritese/transportuese si dhe rrespektimin e rregullave të veçanta për transportin, lëvizjen, vendosjen në bazament dhe montimin.
- Punimet për kabllimin, testimin, komisionimin e tyre, të cilat kryhen për secilin element kanë nevojë për operatorë shumë të specializuar për shkak të vështirësive, kompleksitetit të punimeve dhe kanë një kosto relativisht të madhe.
- Mbrojtja rele është një pajisje komplekse që shfrytëzon të dhëna të kombinuara (rryme/tension) dhe mbrojtje rryme, të cilat kablohen duke krijuar llogjika për bllokime elektrike për mosveprim në rast veprimesh të gabuara. Mbrojtjet rele dhe automatika (BCU) vendosen në panele të veçanta.
- Për testimin dhe komisionimin e saj ndiqet një procedurë e standardizuar IEC. Kompleksiteti i punës në to kërkon gjithashtu punonjës me specializim të lartë dhe njohuri të thella për pajisjet.
- Matja vendoset në panele të veçantë dhe ndiqet një procedurë e standardizuar testimi që është e rregulluar nga norma të rrepta IEC. Operatorët janë tepër të specializuar.
- Në një nënstacion bëhen punime për SKADEN dhe Telekomunikacionin që kërkojnë njohje të pajisjeve dhe specializim të lartë të operatorëve dhe kompanive që punojnë.
- Punimet për ndërtimin/rikonstruksionin/punimet e linjave të tensionit të lartë kanë vështirësi që lidhen me projektimin, ndërtimin, vendosjen e shtyllave, përcjellësve dhe elementeve të ndryshëm përbërës të saj. Ndërtimi i një linje të tensionit të lartë kërkon makina dhe pajisje speciale pa të cilat kompromentohet seriozisht cilësia e punimeve për ndërtimin e tyre. Ndërtimi i linjave të tensionit të lartë kërkon kushte teknike të veçanta dhe shumë të rrepta pasi ato ju nënshtrohen kushteve atmosferike tepër të rënda dhe duhet të paraqesin qëndrueshmëri të mjaftueshme mekanike ndaj tyre.
- Mund të pohojmë se, kompleksiteti, vështirësia dhe rëndësia e punimeve të sipërpërmendura rritet me rritjen e nivelit të tensionit (ndryshimi mes 220 kV dhe niveleve të tjera më të ulëta të tensionit) dhe përcakton në mënyrë domethënëse edhe kërkesat për nivelin profesional të operatorëve që do të kryejnë ato si dhe përdorimin e makinave dhe pajisjeve.

Theksojmë se: në përcaktimin e kushteve për punime në objektet e OST sh.a., përveç rregulloreve tona, është marrë si model edhe procedura dhe kërkesat teknike të ndjekura nga Kontraktorë të

huaj shumë të njohur dhe me eksperiencë që kanë punuar në objektet tona prej më shumë se 15 vite.

---

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence profesionale në fushën e projektimit ose të ketë marrveshje kontraktuale me disponuesit e ketyre licencave, leshuar nga organet perkatese, e cila të përmbajë kategorit e meposhtme:*

<i>Projektues konstruktor</i>	<i>- Pika 3/b</i>
<i>Projektues instalator</i>	<i>- Pikat 4/c</i>
<i>Projektues rruge</i>	<i>- Pika 6/a</i>
<i>Projektues gjeodet</i>	<i>- Pikat 8/a, d</i>
<i>Studim gjeologo inxhinierik - hidrogjeologjik</i>	<i>- Pikat 9/b, d</i>
<i>Projektim impianteve ... të shpernd. en. elektrike</i>	<i>- Pika 10/ d</i>

**Argumentimi:** Keto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngusht me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktoje disponuesit e ketyre licencave, nese nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues ose personi fizik apo juridik që disponon licencat e projektimit dhe që ka marrveshje kontraktuale me ofertuesin për realizimin e projektit, duhet të disponojë:*

- a) *Program të licencuar “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashëm;*
- b) *Të pakten 1(nje) Inxhinier Elektrik të certifikuar për përdorimin e programeve “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashme për realizimin e projektit të linjes, i cili të figurojë në listpagesa të pakten 12 muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Lidhur me inxhinierin elektrik të kërkuar me sipër, ekonomik ofertues duhet të disponojë për punonjesin e sipërcituar: kontratën individuale të punës, shoqëruar me diplomën perkatese të, certifikimin për përdorimin e programeve “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashme, si dhe listepagesat për periudhën e kërkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Kjo kerkese eshte e domosdoshme pasi OST disponon licenca dhe perdor per projektimin e linjave softin PLS – CADD dhe shtyllat me PLS – TOWER. Ne menyre qe te analizohet lehtesisht projekti i hartuar nga kontraktori pervec dokumentacionit me ralcionin e printuar do te kerkohet dhe nje kopje elektronike e projektit ne CD. Kjo do te jete ne formatin “.bak” dhe me pas do te ekstraktohet nga stafi teknik i OST per te kontrolluar projektin e linjes e paraqitur per aprovim, llogaritjet e shtyllave ngarkesat mekanike dhe kriteret me koheficentet e sigurise se aplikuar.

Gjithashtu ne menyre qe te mos kete kufizim tregu ne ofertim eshte lene mundesia dhe per aplikacione te tjera te ngjashme mjafton qe kopja elektronike e projektit te jete ne formatin “.bak” file ne menyre qe projekti te jete i lexueshem nga softet i instaluar ne kompjuterat e OST sh.a.

Por eshte e domosdoshme qe nje operator ekonomik ose personi qe do te hatoje projektin te kete nje licencim ose trajnim personal qe deshmon kapacitet teknike dhe aftesine ne perdorimin e ketij softi apo softeve ekuivalente.

Me ane te softit PLS CADD ndertohet profili gjatesor, llogariten varjet e percjellesit, behet shtyllezimi i linjes, nxirren ngarkesat e strukturave nga percjellesit dhe modelohen shtyllat. Per kete arsye eshte e nevojshme qe punonjesi qe do te pergatise projektin e linjes te jete inxhinier elektrik.

Ky është një kriter i nevojshëm dhe i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim për të vërtetuar kapacitetet e ofertuesit mbi realizimin me suksese të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky aplikacion sherben dhe eshte i lidhur ngushtesisht me realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi. Ky aplikacion nuk e kufizon konkurrencen per shkak se mund te blihet lehtesisht nga OE ofertues.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorite e meposhtme:*

*Punime te pergjithshme ndertimi:*

<i>Kategoria NP-1</i>	<i>Punime germimi ne toke</i>	<i>Klasifikim B</i>
<i>Kategoria NP-2</i>	<i>Ndertime civile dhe industriale</i>	<i>Klasifikim D</i>
<i>Kategoria NP-4</i>	<i>Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale</i>	<i>Klasifikimi B</i>
<i>Kategoria NP-9</i>	<i>Punime dhe mbrojte lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NP-11</i>	<i>Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise</i>	<i>Klasifikim G</i>

<i>Kategoria NP-12</i>	<i>Punime te inxhinierise se mjedisit</i>	<i>Klasifikimi B</i>
<i>Kategoria NS-13</i>	<i>Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni</i>	<i>Klasifikimi C</i>
<i>Kategoria NS-18</i>	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NS-20</i>	<i>Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje</i>	<i>Klasifikimi A</i>

**Shenim:**

- i. Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.*

**Argumentimi:** Keto kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe te lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht punonjesit si me poshte vijon:*

- Si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier ndertimi, 1 (nje) inxhinier elektrik, 1 (nje) inxhinier mekanik, 1 (nje) inxhinier topograf/Gjeodet, 1 (nje) inxhinier elektronik, 1 (nje) inxhinier mjedisi, 1 (nje) inxhinier gjeolog. Inxhinieret e mesiperme duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 12 (dymbedhete) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*
- Gjithashtu si pjese e stafit te Tij ofertuesi pervec inxhiniereve te mesiperme duhet te kete dhe 2 (dy) inxhinier elektrik, 1 (nje) inxhinier mekanik, 1 (nje) inxhinier hidroteknik, 1 (nje) inxhinier pyjesh, 2(dy) teknik ndertimi. Inxhinieret e mesiperme duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 12 (dymbedhete) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje per punonjesit e sipercituar: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhiniereve te mesiperme, licensen e shoqerise si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*



**Argumentimi:** Kërkesa për inxhinieriët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjesve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri i punonjesve të siguruar duhet të jete jo me pak se 100 (njqind) punonjes për 12 (dymbëdhjete) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Lidhur me këte pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje vertetim të leshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jete i percaktuar numri i punonjesve të siguruar, shoqeruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjesve është perlllogaritur duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të objektit të prokurimit, si dhe volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 30 (tridhjetë) punonjes, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, nga të cilët 10 (dhjetë) të jenë punonjes me kategorinë e sigurimit teknik IV-V, të leshuar nga shoqeri të akredituara në bazë të ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:*

- i) listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar si dhe*
- ii) kartelat perkatese te vlefshme te sigurimit teknik.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Në lidhje me kërkesën për personelin e pajisur me kartelat e sigurimit teknik, operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje dhe të paraqese kartelat përkatëse të punonjësve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numer i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe cdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Punonjesit qe do te realizojne kete kontrate, per arsye te natyres teknike te saj dhe kushteve te punes ne linjat e tensionit te larte, duhet te respektojne rregulloren e sigurimit teknik elektrik, bazuar ne dispozitat ligjore perkatese per punimet mbi 1000 Volt, ne lartesi, me heqje dhe pa heqje tensioni, duke repsektuar largesine me tensionin nominal te punes per linjat 400/220 kV.

Kjo kerkese eshte ne përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 1(nje) punonjes, te trajnuar dhe te pajisur me certifikate per perdorim Makineri shtrirje + terheqje dhe frenim percjellesi (percj., tros, opgw) 12 (dymbedhete) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me certifikaten si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Kerkesa per kete punonjes eshte e lidhur ngushtesisht me realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi. Kjo kerkese për kualifikim eshte në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës, sipas objektit të saj.

*2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të pakten 24 (njezet e kater) punonjës të certifikuar për punime në lartësi ku njëri prej tyre të jetë inxhinier i trajnuar dhe i pajisur me certifikate si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë me rrisht të lartë, të cilët duhet të jenë të sigurvejtar jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë: kontratat individuale të punës, shoqërua me, certifikatat si dhe listepagesat për periudhën e kërkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Në lidhje me stafin teknik të certifikuar për punime në lartësi, argumentohet se realizimi i punimeve objekt kontrate kërkon punonjës që kanë aftësitë fizike dhe teknike për të punuar në kushte të vështira të punës, në shtylla të tensionit të lartë dhe në lartësi nga toka.

Përsa i përket kërkesës për një inxhinier të trajnuar dhe të pajisur me certifikate si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë me rrisht të lartë, argumentohet se është i nevojshëm të qendrohet në kantierin e punimeve për të ndjekur ecurinë e punës së punonjësve të OE ofertues dhe të jetë i gatshëm në rastin e paraqitjes së kushteve të rrezikshme që mund të ndodhin gjatë zbatimit të kontratës objekt prokurimi, në përputhje me Ligjin Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 1 (një) Inxhinier elektrik të certifikuar për: arkitekturën dhe skemat e Nënstacioneve elektrike të TL; mbrojtje dhe komandime; Scada/RTU dhe rele, të cilët duhet të jenë të sigurvejtar jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë: kontratat individuale të punës, shoqërua me diplomën e Inxhinierve elektrik, certifikatat si dhe listepagesat për periudhën e kërkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Kërkesa për inxhinierin e sipërcituar është e lidhur me objektin e kontratës dhe natyrën e profilit të inxhinierit elektrik, si dhe në mbështetje me natyrën specifike që kanë këto pjesë të rëndësishme të kontratës objekt prokurimi. Kjo kërkesë për kualifikim është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

*2.3.11 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:*

<b>Nr.</b>	<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>
1	Buldozer (traktor) $\geq 80$ HP	2 cope
2	Eskavator me kove $\geq 0.5$ m <sup>3</sup>	2 cope
3	Mak. Vetengark. Fadrome $0.5 \div 1$ m <sup>3</sup>	2 cope
4	Autobetoniere $\geq 3.75$ m <sup>3</sup>	2 cope
5	Autovinc $\geq 5$ Ton	3 cope
6	Motoarganello (me benzine)	3 cope
7	Makineri shtrirje + terheqje teli (percj., tros, opgw)	2 sete
8	Motopresa (tubat e bashkimit)	2 cope
9	Vinc tip falkone (pa motoarg.)	3 cope
10	Kamion $\div 20$ Ton (dumper)	2 cope
11	Kamion $\div 10$ Ton (dumper)	2 cope
12	Trailer (kamion transport konteneresh)	1 cope
13	Autovinc $\geq 30$ Ton	2 cope
14	Instrument për matjen e dispresionit kromatik me shtrirje dinamike min 55 db	1 cope

*Si deshmi për plotesimin e kësaj pike operatori duhet të disponojë:*

- 1. Për mjetet, makinerite dhe pajisjet në pronësi të paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)*
- 2. Për mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje (ose formë tjetër huaje) si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit të bërë me lart. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve.*

3. *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi) dhe akti i kolaudimi.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Mjetet dhe pajisjet teknike te vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjate realizimit te kontrates objekt procedure prokurimi, për realizimin e punimeve që do të kryhen në kantier. Kjo kërkesë është minimale dhe jodiskriminuese në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/d, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.12 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- a. *ISO 9001: certifikaten e menaxhimit te cilesise se punimeve, qe ka lidhje me objektin e kontrates;*
- b. *ISO 45001: certifikaten e sistemit te menaxhimit te sigurise ne pune, qe ka lidhje me objektin e kontrates;*
- c. *ISO 14001: per sistemin e menaxhimit mjedisor, qe ka lidhje me objektin e kontrates;*
- d. *ISO 27001: per sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit, qe ka lidhje me objektin e kontrates;*
- e. *ISO 39001: Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor;*
- f. *ISO 50001: Per sistemin e menaxhimit te energjise.*

**Argumentimi:** Ne lidhje me kërkesën qe OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare, të objektit të kontratës.

**Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001:** eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

**Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:** është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të veçantë për kryerjen e kësaj kontrate. OE ofertues që do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi duhet të kryejë punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet që mund të shfaqen gjatë realizimit të kësaj kontrate.

**Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001:** e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues është i certifikuar për produkte dhe punime të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

**Certifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:** është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht në sistemin elektro-energjitik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur nga Kontraktori. Certifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme AK.

**Certifikatë për sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor ISO 39001:** është standardi ndërkombëtar që ofron kuadrin për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor (RTSMS), kjo certifikatë kërket nga AK me qëllim për të garantuar se OE është i certifikuar për sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor për arsye transportit të materialeve objekt punimi të cilat do të behen në vende të ndryshme jo të urbanizuara dhe që do të ketë nevojë për levizjen e pajisjeve të renda teknologjike.

**Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të Energjisë ISO 50001:** është e nevojshme si kriter kualifikues, pasi lidhet me natyrën e kontratës, veprimtarinë dhe përdorimin e pajisjeve për të cilat duhet të ketë një siguri që nuk shpërdorohet energjia e nevojshme gjatë realizimit të punimeve. Me anë të këtij certifikimi, identifikohen dhe menaxhohen rreziqet që lidhen me furnizimin e ardhshëm të energjisë, mundësohet matja dhe monitorimi i përdorimit të energjisë për të identifikuar se ku të përmirësohet efikasiteti. Po ashtu do të përmirësohet performanca e përgjithshme për të ulur konsumin e energjisë, etj.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*2.3.13 Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë:*

- ✓ *Licence leshuar nga QKL për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis me kod III.2.A.*

- ✓ *Licence leshuar nga QKL per sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me kod III.2.B (transportimi i mbetjeve te llojeve te ndryshme).*

*Nese Operatori Ekonomik ofertues nuk i disponon keto licenca atehere ai mund te beje nje marrveshje kontraktuale me personin fizik apo juridik qe i disponon keto licenca.*

**Argumentimi:** Kjo kerkese eshte bere duke patur parasysh qellimin dhe rreziket e ndotjes mjedisore qe mund te shkaktoje kjo kontrate gjate zbatimit te saj, per shkak te grumbullimit, transportimit dhe ndikimit ne mjedisin e kantierit te punimeve, sipas parashikimeve te Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është në përputhje me Fushën III “Mjedisi dhe burimet mjedisore bazë”, Kategoria III.2, Pika 9, e VKM Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Ky është një kriter i nevojshëm dhe i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me to, me qëllim për të vërtetuar kapacitetet e ofertuesit mbi realizimin me suksese të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*2.3.14 Operatori ekonomik ofertues duhet te plotesoje saktesisht kolonen me te dhenat teknike te ofertuar ne te gjitha tabelat e paraqitura ne Shtojcen 5 (Specifikimet teknike) te ketyre DT-ve, ku kerkohet.*

***Mosplotesimi i sakte eshte element skualifikimi.***

**Argumentimi:** Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njih konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në procedurën objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

*2.3.15 Per listen e meposhtme te mallrave:*

- 1. Shtylla metalike (sipas specifikimeve teknike)*
- 2. Percjelles (sipas specifikimeve teknike)*
- 3. Denfera (sipas specifikimeve teknike)*
- 4. Girlanda (Sipas specifikimeve teknike)*
- 5. Tros (sipas specifikimeve teknike)*
- 6. OPGW (sipas specifikimeve teknike)*
- 7. Morseteri (sipas specifikimeve teknike)*

8. Çelës SF6 (sipas specifikimeve teknike)
9. Izolatore (Sipas specifikimeve teknike)
10. Ndarës (sipas specifikimeve teknike)
11. Transformator rryme (sipas specifikimeve teknike)
12. Transformator tensioni (sipas specifikimeve teknike)
13. Shkarkues (sipas specifikimeve teknike)
14. Pajisjet e matjes (sipas specifikimeve teknike)
15. Pajisjet e komandimit (sipas specifikimeve teknike)
16. Pajisjet e mbrojtjes (sipas specifikimeve teknike)
17. Salle baterish (sipas specifikimeve teknike)
18. Paneli AC per nevojat vetjake (sipas specifikimeve teknike)
19. Paneli DC per nevojat vetjake (sipas specifikimeve teknike)
20. Radrizator/karikues i baterive (sipas specifikimeve teknike)
21. Pajisjet e sistemit te kontroll monitorimit (sipas specifikimeve teknike)
22. Pajisjet e telekomunikacionit (sipas specifikimeve teknike)

*Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:*

1. *Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze.*

*Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

**Argumentimi:** Në lidhje me kriterin për listën e mallrave që do të përdoren, nisur nga rëndësia e madhe e projektit dhe funksioni që ato do të kryejnë në realizimin e objektit të kontratës, si dhe nga vlera e tyre, u mendua që ky kriter të mundësojë sigurimin e mallrave cilësore me parametra që plotësohen nga prodhues të certifikuar për menaxhimin e cilësisë së mallrave. Ky kriter është në proporcion me vlerën e kontratës, është jodiskriminues dhe i mundshëm të përmbushet nga cdo operator që ka përvojë në këtë fushë objekt kontrate.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.



2.3.16 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per punimet objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik".*